



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë
Ministrasvo - Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm

Doracak për mësimdhënës

Maj, 2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë
Ministrastvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm

Doracak për mësimdhënës

Maj, 2018

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Fondacionin Evropian për Demokraci (EFD). Projekti është mundësuar përmes ndihmës financiare nga qeveria italiane.

Në hartimin e këtij dokumenti kontribut të veçantë kanë dhënë anëtarët e Grupit teknik për zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 (renditje alfabetike): Afërdita Jaha, Afërdita Kryeziu, Arbër Salihu, Bashkim Shala, Fatime Jasiqi, Habib Aliu, Merita Jonuzi, Mimoza Hasani-Pllana, Ryve Prekorogja dhe Veton Alihajdari.

Ky publikim nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet/mendimet e UNDP-së.

Përmbajtja

Hyrje	5
Qëllimi	8
Përkufizimet	8
Shenjat e para të radikalizimit	11
Sfidat dhe mundësitë për veprim	14
Pasqyra e iniciativave parandaluese në Kosovë	33
Iniciativat në nivel qendror	33
Iniciativa në nivel lokal	35
Referencat	36
Shtojcat	37
Shtojca A Parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve	37
Shtojca B Raportimi i rasteve të dhunës në institucionet e arsimit para-universitar	38
Shtojca C Dokumentet dhe korniza ligjore	40
Shtojca D Mënyrat strategjike për të mbështetur shkollat në gjetjen e partnerëve	43
Fjalorthi	44

Viteve të fundit vërehet një trend në rritje i rasteve të ekstremizmit të dhunshëm në mbarë botën, raste këto të cilat nuk janë të izoluara vetëm në një rajon apo në një vend, por janë prezente nëpër shumë vende. Për Kosovën, rreziku nga ekstremizmi i dhunshëm, nuk është vetëm global, por përbën edhe kërcënim lokal, i cili duhet të merret parasysh shumë seriozisht.¹ Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, gjithsej 360 kosovarë kanë udhëtuar në Siri, prej të cilëve 255 ishin luftëtarë që u bashkuan me grupet e dhunshme ekstremiste si ISIS, Jabhat Al Nusra, një degë e Al Kaedës si dhe grupi islamik Ansar al Sham. Prej tyre 48 ishin gra dhe 57 ishin fëmijë. Gjithashtu, rreth 36 fëmijë kanë lindur në zonën e konfliktit, që do të thotë se 93 fëmijë mbeten ende në zonat e konfliktit.²

Në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, Qeveria e Kosovës, në vitin 2015, miratoi dokumentin: "Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020". Strategjia adreson rrezikun e sigurisë që vjen nga radikalizmi dhe ekstremizmi në një mënyrë të përgjegjshme, duke garantuar të drejtat e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose të origjinës kombëtare apo sociale të të tjerëve, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".³ Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që përmes kësaj strategjie të kontribuojë në implementimin e konkluzioneve të Samitit të Washingtonit në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, për t'u bashkuar dhe koordinuar në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit dhe ruajtjen e tolerancës fetare në mbarë globin, e në veçanti në vendet e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm.⁴

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm është një çështje komplekse në mbarë botën, andaj është shumë e vështirë të identifikohet një zgjidhje e vetme që mund ta trajtojë këtë çështje. Megjithatë, është e qartë se rritja e ndërgjegjësimit tek mësimdhënësit mund ta zvogëlojë dhe ta parandalojë ndikimin e nxënësve dhe të rinjve karshi mesazheve dhe rrëfimeve potencialisht radikale. Me qëllim të parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm bashkëpunimi midis nxënësve, mësimdhënëseve, administratës së shkollës dhe prindërve duhet të rritet. Edukimi dhe arsimimi ndoshta nuk

1 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 'Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 (Shtator 2015)

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

2 UNDP, Faktorët shtytës dhe tërheqës në Kosovë, 2017 fq.7

http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PVE/UNDP_Push%20and%20Pull%20Factors_ENG.pdf

3 Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

4 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 'Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 (Shtator 2015)

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

mund tërësisht ta ndalojnë një individ nga kryerja e një veprimi të dhunshëm në emër të një ideologjie të dhunshme ekstremiste, por ofrimi i edukimit dhe arsimimit përkatës dhe cilësor mund të ndihmojë në krijimin e kushteve që e bëjnë të vështirë përhapjen e ideologjive dhe akteve të dhunshme.⁵

Është shumë e rëndësishme që institucionet qeverisëse të nivelit qendror dhe lokal, institucionet e sigurisë, Bashkësia Islame në Kosovë, bashkësitë tjera fetare dhe shkollat të kërkojnë mënyra më të mira për ta trajtuar radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në mesin e të rinjve për të qenë të afta për të ndërmarrë masa proaktive, që do ta parandalonin radikalizmin e të rinjve. Qëllimi i tyre përfundimtar duhet të jetë forcimi i rezistencës ndaj kësaj dukurie në sistemin arsimor të Kosovës.

Për këtë qëllim, doracaku është në përputhje me 'Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020'⁶ dhe Planin e tij të Veprimit. Objektivat themelore janë: rritja e ndërgjegjësimi të institucioneve që punojnë në këtë fushë, nxitja e bashkëpunimit me komunitetin dhe ngritja e kapaciteteve të këtyre institucioneve, për t'i trajtuar më mirë sfidat me të cilat përballen. Më konkretisht, doracaku ndërlidhet edhe me 'Objektivin Strategjik 1 - Identifikimin e hershëm - të shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të synuara'. Strategjia thekson nevojën që mësimdhënësit, pedagogët dhe psikologët të përfshihen në identifikimin e hershëm të radikalizmit në mesin e nxënësve. Doracaku mëton të shërbejë për këtë qëllim.

Rëndësia e përqendrimit të doracakut mbi ekstremizmin e dhunshëm nga perspektiva e mësimdhënësve është për shkak të rolit të rëndësishëm që mësimdhënësit dhe shkollat luajnë në sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve. Ata janë në një pozicion kyç për t'i mbrojtur nxënësit nga rreziqet e rrëfimeve ekstremiste. Ndihma për t'i mbrojtur nxënësit nga ndikimet ekstremiste dhe radikalizmi, është një pjesë e rëndësishme e rolit të mësimdhënësve në përgjithësi në mbrojtjen e nxënësve të tyre. Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, po ashtu kanë një efekt të ngjashëm dëmtues për nxënësit, familjet dhe komunitetet. Fëmijët dhe të rinjtë janë veçanërisht të cenueshëm ndaj radikalizmit dhe shumë prej tyre kërkojnë përgjigje për pyetjet rreth identitetit, besimit dhe përkatësisë, si dhe janë në kërkim të aventurës dhe kënaqësive të ndryshme. Grupet ekstremiste, qofshin ato të ekstremizmit fetar, politik, nacional apo formave tjera ekstremiste, pretendojnë të ofrojnë përgjigje dhe t'u premtojnë një ndjenjë identiteti nxënësve që janë të

5 UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzues për mësimdhënësit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. 2016. fq. 13. <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

6 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 'Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 (Shtator 2015)

cenueshëm. Edhe pse rastet janë të rralla, prapseprapë ka edhe fëmijë shumë të vegjël që mund të ekspozohen ndaj ekstremizmit, brenda dhe jashtë shtëpisë, apo përmes internetit, videove dhe lojërave.

Për më tepër, doracaku do t'u shërbejë mësimeve që klasat e tyre të jenë mjedise të sigurta, ku idetë dhe çështjet kundërthënëse të mund të diskutohen lirshëm dhe në mënyrë të hapur. Krijimi i këtij mjedisi do t'u ndihmonte nxënësve që t'i sfidonin argumentet ekstremiste, duke u ofruar atyre aftësi dhe njohuri që në mënyrë kritike t'i analizojnë çështjet, shoqërore, kulturore dhe politike, si dhe duke përdorur fakte të arrij tek një argumentim i arsyeshëm.⁷

7 Departamenti i Edukimit dhe Home Office, 2018, Fusha për mësimeve:
<https://educateagainsthate.com/>

Qëllimi

Qëllimi i këtij doracaku është që të ofrojë udhëzime për mësimdhënësit në Kosovë për trajtimin e sfidave konkrete të paraqitura nga ekstremizmi i dhunshëm në mjedisin shkollor.

Doracaku paraqet zgjidhje të dobishme dhe praktike për veprim, duke demonstruar si mund të reagojnë mësimdhënësit në mënyrë të përshtatshme pedagogjike ndaj situatave sfiduese në aspektin profesional, ligjor ose mënyrave tjera pedagogjike.⁸

Doracaku duhet të përdoret në përputhje me Doracakun për Zbatimin e Rregullores Nr. 21/2013 Protokollin për Parandalimin dhe Referencën e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar. Po ashtu doracaku duhet të udhëhiqet nga parimet e protokollit dhe parimet bazë të Konventës për të Drejtën e Fëmijëve.⁹ Ndërhyrjet e mësimdhënësve duhet të jenë në përputhje të plotë me respektimin e lirisë së besimit dhe lirisë fetare ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përkufizimet

Terminologjia lidhur me ekstremizmin e dhunshëm është komplekse dhe si e tillë ende e debatueshme. Kjo është për shkak të një sërë arsyes, por në radhë të parë është për faktin se termat që përdoren në këtë fushë nuk janë përkufizime të pranura në mënyrë universale.

Për shkak se nuk ka konsensus mbi përkufizimet, UNESCO ka rekomanduar që nocionet të diskutohen dhe të përcaktohen në nivel kombëtar, si parakusht për çdo planifikim, në mënyrë që plotësisht të kuptohen ndikimet e shumëfishta të secilit term.

Megjithatë, për qëllime të këtij doracaku, përkufizimet e dhëna më poshtë, janë përkufizime të përdorura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën e Kulturën (UNESCO).

Ekstremizmi nënkupton "besimin dhe mbështetjen për idetë që janë shumë larg nga ajo që shumica e njerëzve i konsiderojnë të sakta ose të

8 Ky doracak është hartuar sipas kërkesës së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të miratuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe e mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë si një përgjigje ndaj zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020.

9 Për më shumë rreth parimeve bazë të Konventës për të Drejtën e Fëmijëve shiko Shtojcën B

arsyeshme". Pra "ekstremizmi" i referohet qëndrimeve ose sjelljeve që konsiderohen jashtë normës.

Ekstremizmi i dhunshëm - i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që e mbështesin ose e përdorin dhunën për t'i arritur qëllimet ideologjike, fetare apo politike. Kjo përfshin terrorizmin dhe format e tjera të dhunës së motivuar politikisht apo edhe nga sektet e ndryshme. Në mënyrë të veçantë, "ekstremizmi i dhunshëm" gjithashtu identifikon një armik ose armiqtë, të cilët janë objekt i urrejtjes dhe dhunës. Bërthama konceptuale e ekstremizmit të dhunshëm është se ajo është një mjet i motivuar ideologjikisht për përdorimin e dhunës, zakonisht e bazuar në teoritë e konspiracionit.

Radikalizmi - Ashtu si me termin "ekstremizëm", termi "radikalizëm" diskutohet shumë kur përdoret në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm. Shqetësimi është se përdorimi i termit mund të shërbejë për t'i arsyetuar kufizimet e fjalës së lirë. Në të vërtetë termi "radikal" në kontekste të caktuara, thjeshtë ka kuptimin e asaj "që dëshiron të shkaktojë ndryshime politike". Në kontekstin e përpjekjeve për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, "radikalizmi" zakonisht përdoret për t'i përshkruar proceset, me të cilat një person ka pikëpamje apo përdorë praktika ekstreme, deri në atë pikë sa ta legjitimojë përdorimin e dhunës.

De-radikalizmi: Aktivitetet e ndërmarra për ta ndryshuar mentalitetin e një individi të radikalizuar kundrejt pranimi ose miratimit të një ideologjie të dhunshme ekstreme, me qëllim që ta pengojë atë për të ndërmarrë veprime të dhunshme në të ardhmen.

Faktorët shtytës dhe tërheqës

Në lidhje me rrënjët e ekstremizmit të dhunshëm dhe shkaqet e radikalizmit që çojnë në dhunë ekzistojnë faktorë të ndryshëm dhe shumë-shtresor. Nuk ka asnjë shenjë të vetme që tregon me ndonjë siguri, se një person është në rrezik. Tradicionalisht, shtytësit e ekstremizmit të dhunshëm ndahen në dy kategori: faktorët "shtytës" dhe "tërheqës". Kuptimi i këtyre ngjyrymeve është shumë i rëndësishëm, me qëllim që të shmangen përgjithësimet të cilat mund ta shkaktojnë stigmatizimin e popullatës, ta prodhojnë ndjenjën kolektive të pakënaqësisë si dhe të ushqejnë edhe më tej rrëfime të dhunshme ekstremiste.

Faktorët “shtytës” dhe “tërheqës” janë çështje shumë të rëndësishme që duhet të adresohen në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Faktorët “shtytës” – Përkufizime të përgjithshme	Faktorët “shtytës” – Specifike për kontekstin e Kosovës
► Margjinalizimi dhe pabarazia ► Diskriminimi, persekutimi ose perceptimi mbi persekutimin ► Mundësia e kufizuar për arsim cilësor ► Mohimi i të drejtave dhe lirive qytetare dhe probleme të tjera mjedisore, dhe socio-ekonomike.	► Faktorët ekonomik dhe social ► Papunësia ► Sistemi i dobët arsimor ► Izolomi i të rinjve dhe mungesa e mundësive për udhëtime ► Kapacitete të dobëta institucionale ► Solidarizimi fetar dhe tjetërsimi për shkak të pikëpamjeve fetare

Faktorët “tërheqës” - Përkufizime të përgjithshme ¹⁰	Faktorët “tërheqës” – Specifike për kontekstin e Kosovës
► Ekzistenca e grupeve të mirë-organizuara të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive ► Ofrimi i shërbimeve, të ardhurave dhe/ose punësimi në këmbim të anëtarësimi. ► Ofrimi i zgjidhjeve për anëtarët e rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri. ► Ofrimi i “ndjenjës së përkatësisë” dhe një rrjeti mbështetës social.	► Rrjetet aktive të rekrutimit, kryesisht të përbëra nga udhëheqës radikal të arsimuar në disa universitete të Lindjes së Mesme ► Ndërhyrjet ndërkufitare të imamëve radikal dhe ekstremist dhe individëve në mes të Kosovës dhe Maqedonisë ► Radikalizmi online ► Kërkimi i identitetit dhe shpërblimet ► Përhapja e mediave ekstremiste përmbajtjeve ekstremiste në rrjetet sociale¹¹

10 UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzuesi për mësimdhënës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. 2016
<http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

11 UNDP-USAID Raporti i Pulsit Publik, 2017
http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiii

Shenjat e para të radikalizmit

Mësimdhënësit e luajnë një rol qenësor në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm – jo si agjent të mbikëqyrjes por si edukatorë. Në kontakt të drejt-përdrejtë me të rinjtë, ata mund të jenë model ndryshimi por edhe ndërmjetësues, duke e nxitur dialogun dhe duke e fuqizuar respektin e ndërsjellë. Është e rëndësishme të theksohet se nuk ka asnjë faktor përcaktues apo indikatorë të ndryshëm, që ekzistojnë për të përcaktuar nëse një nxënës/nxënëse është radikalizuar. Përkundrazi, duhet të përdoret një qasje gjithëpërfshirëse, për ta kuptuar sjelljen e përgjithshme të nxënësit dhe ndërveprimin e tij me bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit. Ka raste kur ndërhyrja është jetësore dhe e domosdoshme. Inkurajimi i zhvillimit të mendimit individual është thelbësor për zhvillimin e nxënësve dhe duhet të merret parasysh kur merret vendimi për të ndërhyrë. Fëmijët, me përkatësi të ndryshme kulturore ose fetare, mund të radikalizohen. Më poshtë janë të paraqitur vetëm disa nga faktorët që i bëjnë të rinjtë të pambrojtur ndaj radikalizmit. Andaj, është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit t'i njohin faktorët që i bëjnë nxënësit më të prekshëm ndaj radikalizmit.

Shenjat identifikuese të paraqitura më poshtë duhet të përdoren vetëm si një udhëzues, për shkak se mësimdhënësit këshillohen që ta përdorin gjykimin profesional për t'i vlerësuar dobësitë e nxënësve.

Kush është më i ndjeshëm ndaj radikalizmit?

- ▶ Ata/ato të cilët luftojnë për një ndjenjë identiteti
- ▶ Distancohen nga përkatësia e tyre kulturore ose fetare
- ▶ Vënia në dyshim e pozitës së tyre në shoqëri
- ▶ Çështjet familjare
- ▶ Përjetimi i një ngjarje traumatike
- ▶ Përjetimi i racizmit ose diskriminimit
- ▶ Vështirësia në bashkëveprimin social
- ▶ Mungesa e ndjeshmërisë
- ▶ Vështirësi në të kuptuarit e pasojave të veprimeve të tyre
- ▶ Vetëbesimi i ulët

Faktorët e jashtëm gjithashtu e luajnë rolin e tyre, siç janë: konfliktet në komunitet, ngjarjet që prekin vendin ose rajonin e prejardhjes së prindërve, apo edhe të pasurit miq ose familjar që u janë bashkuar grupeve ekstremiste.

Radikalizmi i fëmijëve mund të ndodhë gjatë një periudhe të gjatë kohore. Në disa raste, radikalizmi mund të ndodhë shumë shpejt, duke e shkaktuar nga një incident ose një lajm të caktuar. Ndonjëherë ka shenja të qarta të radikalizmit, në raste të tjera ndryshimet janë më pak të dukshme. Vitet e adoleshencës janë një kohë e ndryshimit të madh dhe të rinjtë shpesh duan të jenë vetvetja, zemërohen lehtë si dhe shfaqin mosbesim ndaj autoritetit. Kjo e bën të vështirë që ta bëjmë dallimin në mes të sjelljes normale të adoleshentëve karshi një qëndrimi që tregon se një nga nxënësit tuaj mund të ketë qenë i ekspozuar ndaj ndikimeve të radikalizmit.

Shenjat e renditura më poshtë kanë për qëllim të shërbejnë vetëm si një udhëzues për t'ju ndihmuar që ta identifikoni radikalizmin e mundshëm:

Shenjat e jashtme	Sjellja në përgjithësi
► Të qenit gjithnjë e më argumentues ► Refuzimi për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme ► Ndryshimet në qëndrime dhe në sjellje kundrejt të tjerëve: komente antisociale, kundërshtim i autoritetit, mospranim për bashkëveprim social, shenja të tërheqjes dhe izolimit. ► Të qenit abuziv ndaj nxënësve të ndryshëm ► Përvetësimi i teorive të konspiracionit ► Ndjenja e persekutimit ► Konvertimi në një fe të re ► Ngurrimi për ta treguar vendndodhjen e tyre ► Shfaqja e simpatisë për grupe të ndryshme ekstremiste.	► Shkëputja e menjëhershme nga familjarët dhe nga shoqëritë afatgjata. ► Vizita në një xhami ku bëhen interpretime ultra konservatore të Islamit ► Lartësimi i ritualeve të caktuara dhe kërkohet përmbushja në mënyrë jo reflektuese në moshat e hershme. ► Shqetësimi i tepruar për jetën pas vdekjes dhe ferrin ► Largimi nga doket, zakonet dhe mënyra e jetesës dhe refuzimi i praktikave të zakonshme, siç janë ndryshimet në sjelljen e të ngrënit, refuzimi i muzikës ose ndryshimet në aktivitetet e kohës së lirë ► Ndryshimet në sjellje ndaj personave të gjinisë së kundërt; Nënçmimi i grave dhe vajzave ► Braktisja e menjëhershme e shkollës dhe konfliktet me shkollën.

Retorika	Sjellja në rrjetet sociale
▶ Refuzimi i nxënësit për të pranuar ose toleruar një pikëpamje ose grup besimesh të ndryshme nga ato të tyre ▶ Paraqitja e një pretendimi për të vërtetën ▶ Rritja e përdorimit të frazave fetare ▶ Refuzimi kategorik i pikëpamjeve të tjerëve (nga nxënësit ose mësimdhënësit) si të rremë, jo-islam, imoral, mëkatar ose haram ▶ Refuzimi i demokracisë dhe i të drejtave të njeriut ▶ Prirja për t'iu referuar teorive apokaliptike dhe konspirative ▶ Paraqitja e një botëkuptimi të mbyllur, bardhë e zi	▶ Ndryshimi i identitetit në internet ▶ Të pasurit më shumë se një identitet në rrjete sociale ▶ Kalimi i më shumë kohe në internet ose në telefon ▶ Përdorimi i përmbajtjes ekstremiste në internet ▶ Bashkimi ose përpjekja për t'u bashkuar me një organizatë ekstremiste ▶ Ndjekja e rregullt e faqeve të internetit dhe pjesëmarrja në faqe interneti dhe rrjete të mediave sociale, të cilat nuk i dënojnë pikëpamjet radikale ose ekstremiste.¹²

Shënim: Ju si një mësimdhënës i njihni më së miri nxënësit tuaj, kështu që jeni në një pozitë kyçe për të njohur nëse ata veprojnë jashtë karakterit. Besoni dhe kini besim në gjykimin tuaj profesional dhe merrni këshilla nëse diçka nuk shkon si duhet.

¹² UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzuesi për mësimdhënës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.. 2016. P.13.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

Sfidat dhe mundësitë për veprim

Si duhet t'u flas nxënësve të mi për çështje të ndjeshme, siç janë radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe lufta në Siri apo vende të tjera në Lindjen e Mesme?

Sfida:

Shumë mësimmdhënës janë të pasigurt për mënyrat se si duhet të trajtohen temat të vështira si radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm, lufta në Siri apo konflikti në vendet e tjera në Lindjen e Mesme. Disa mësimmdhënës refuzojnë t'i trajtojnë këto çështje, ose u shmangen pyetjeve të nxënësve të lidhura me këto tema, duke pretenduar se këto tema nuk ka nevojë të trajtohen. Megjithatë, mësimmdhënësit duhet të jenë të gatshëm të ballafaqohen me këto tema pasi në kurrikula parashikohet edhe trajtimi i tyre. Mësimmdhënësit janë të shqetësuar se në rastet kur diskutohen këto tema, situata mund të dalë shpejt jashtë kontrollit. Sidoqoftë, pikërisht këto tema kanë rëndësi për nxënësit dhe shmangia e diskutimit për to mund t'i rrisë dyshimet për mungesën e paanshmërisë.

Mundësitë për veprim:

Dihet se të rinjtë kanë interes që t'i diskutojnë ngjarjet aktuale dhe ndërkom-bëtare, prandaj është e rëndësishme që shkollat t'u ofrojnë adoleshentëve një mundësi që të flasin lirshëm për gjërat me interes për ta. Nëse kjo mundësi nuk u ofrohet në klasë, nxënësit do të gjejnë vende të tjera ku mund të diskutojnë dhe të shprehën, ku mund të jenë të cenueshëm prej rrëfimeve negative ose ekstreme. Si rrjedhojë, është e domosdoshme të krijohet një mjedis i sigurt¹³ për të rinjtë, për t'i shprehur mendimet dhe shqetësimet e tyre. Ju duhet të jeni të përgatitur për të ofruar shpjegime kuptimplota për nxënësit edhe kur ata trajtojnë pyetje që nuk lidhen drejtpërdrejtë me mësimet e planifikuara. Fokusi i diskutimeve në klasë duhet të jetë krijimi i një ambienti ku nxënësit mund të tregojnë respekt të ndërsjellë ndaj pikëpamjeve dhe besimeve të njëri-tjetrit. Përgatitja paraprake e zvogëlon frikën e diskutimit të temave të debatueshme kur paraqitet rasti.¹⁴

Megjithatë, nëse nuk ndjeheni rehat me menaxhimin e diskutimeve të tilla me nxënësit, mos u përfshini në bisedë.¹⁵

13 The Council of Europe (2015) Teaching Controversial Issues Through Education for Democratic Citizenship and Human Rights (EDC/HRE), Training pack for Teachers <https://rm.coe.int/16806948b6>

14 UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzuesi për mësimmdhënës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.. 2016. fq. 22. <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

15 Po aty fq. 23

Nëse dialogu me disa nxënës/nxënësve bëhet i pamundur, është e nevojshme të lajmërohet drejtori i shkollës, i cili do t'i ndërmarrë masat e nevojshme në kuadër të rregullave të brendshme të shkollës.

Si duhet t'i trajtoj konfliktet ndërmjet nxënësve me prirje fetare ekstremiste dhe nxënësve të tjerë?

Sfida:

Konflikti ndërmjet të rinjve rreth mendimeve (qëndrimeve) të ndryshme është pjesë normale e jetës shkollore. Megjithatë, këto konflikte shpesh mund të prekin çështje më delikate, siç janë botëkuptimi dhe besimet fetare. Mësimdhënësit mund ta kenë të vështirë që të ndërmjetësojnë në këto diskutime, pa u treguar kundërshtues ose pa shkaktuar reagime të kundërta te një numër i nxënësve.

Mundësitë për veprim:

Konfliktet janë konflikte, pavarësisht nëse lindin në kontekst fetar apo jofetar. Nëse ndonjëri nga nxënësit ose një grup nxënësish i nënçmojnë të tjerët për shkak të mendimeve dhe pikëpamjeve të tyre personale, ose për shkak të paraqitjes së tyre, ju do të duhet ta diskutoni bashkërisht çështjen e pranimit dhe mirëkuptimit reciprok. Është e rëndësishme që secilit t'i jepet mundësia të flasë dhe asnjë person, grup, apo pikëpamje nuk duhet ta dominojë bisedën.¹⁶

Ju duhet të theksoni se të gjithë kemi lindur të lirë dhe i gëzojmë të drejtat e barabarta si qenie njerëzore.¹⁷ Diskutimi i pyetjes "Si duam të jetojmë?" mund t'ju ndihmojë që, me takt, ta hapni me nxënësit temën e diskriminimit dhe t'i ndihmoni që t'i përcaktojnë rregullat për trajtimin e njëri-tjetrit me respekt. Për më tepër, mund t'i theksoni përfitimet që sjell diversiteti në një shoqëri, pasi respekti për diversitetin ushqen ndjeshmërinë dhe dhembshurinë.¹⁸

Ju duhet ta theksoni edhe faktin se problemet dhe konfliktet nëpër botë nuk duhet të kuptohen vetëm në bazë të dallimeve fetare. Kosova është shembull i mirëkuptimit, tolerancës dhe respektit ndërfetar. Mësimdhënësit mund ta theksojnë raportin e mirë që Kosova e ka me vendet e tjera si me ato perëndimore ashtu edhe me ato lindore. Ndonjëherë konfliktet fetare

16 UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzuesi për mësimdhënësit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. 2016. fq. 30.

<http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

17 Deklarata Universale për të drejtat e njeriut: http://www.un.org/en/udhrbook/pdf/udhr_booklet_en_web.pdf

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian: http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

18 Po aty. fq. 36

në mes të nxënësve mund të lindin jashtë mbikëqyrjes suaj por, nëse jeni të informuar për konfliktet, mos e injoroni çështjen. Si mësimdhënës, ju mund t'i hapni këto tema dhe të jepni argumente për t'i bindur nxënësit se konflikti nuk është rruga e duhur për të ecur përpara. Në rast se konflikti vazhdon, është e nevojshme të lajmërohet drejtori i shkollës, i cili do të zbatojë rregullat e brendshme të shkollës, si dhe kornizën ligjore ekzistuese, duke siguruar edhe shërbime të tjera nëse ka nevojë.

Si duhet të reagoj nëse një nxënës/nxënëse thotë se ai ose ajo është mysliman/e, para se ta identifikojnë vetveten sipas etnisë?

Sfida:

Edhe pse rrallë, ka raste kur nxënësit identifikohen së pari nga feja e tyre dhe përpiqen ta përjashtojnë ose ta minimizojnë ndjenjën e tyre të identitetit kombëtar ose përkatësisë etnike. Nëse ata janë rritur dhe socializuar në një mjedis kulturor, ku roli i kombit ose etnisë është zhvlerësuar, ata mund të besojnë se kultura e tyre ose vlerat e fesë së tyre nuk janë në përputhje me "identitetin e tyre etnik" ose "të qenit kosovar".

Mundësitë për veprim:

Është e rëndësishme t'ua mësojmë nxënësve se është e mundur të kombino-hen identitetet komplekse të shtresuara, si dhe të theksohet se pluralizmi konsiderohet pasuri dhe jo një disavantazh në shoqërinë tonë. Përsëri, pyetja "si duam të jetojmë?"^{19 20} mund t'ju ndihmojë t'i diskutoni këto çështje në një mënyrë më pozitive. Ju mund t'i referoheni luftës dhe ta nënvizoni faktin se ne duam të jetojmë në paqe dhe ta zhvillojmë vendin tonë, duke pranuar identitete të ndryshme. Pranimi ose vlerësimi i diversitetit kulturor e fetar prodhon efekte pozitive në shmangien e diskriminimit dhe situatave konfliktuale, ndërkaq e kundërta mund të sjell pakënaqësi dhe rrethana të tjera që e cenojnë paqen dhe sigurinë.

Identitetet fetare mund të jenë më të rëndësishme për disa dhe më pak të rëndësishme për të tjerët, por të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejta të barabarta. Duhet ta theksoni këtë, si dhe të shtoni se të qenit qytetar i Kosovës dhe pjesëtar i një grupi etnik nuk bie ndesh me identitetet e ndryshme fetare.

19 Deklarata Universale mbi Diversitetin Kulturor, UNESCO:
<http://unesdoc.unesco.org/images/0012/001271/127162e.pdf>

20 Diversiteti dhe Pluralizmi – Si mund njerëzit të jetojnë së bashku në paqe?,
Demokracia e gjallë: <http://www.living-democracy.com/textbooks/volume-3/part-1/unit-3/>

Si duhet të veproj në rast se unë nuk jam në gjendje ta identifikoj nënën e një nxënësi, sepse ajo është plotësisht e mbuluar?

Sfida:

Në disa raste, mësimmshënësit e gjejnë veten në situata ku nuk mund ta identifikojnë nënën e një nxënësi, sepse ajo është plotësisht e mbuluar, duke e vështirësuar bashkëpunimin me prindërit si dhe duke e vështirësuar komunikimin e duhur dhe domethënës në lidhje me edukimin e fëmijës/fëmijëve të tyre.

Mundësitë për veprim:

Është e rëndësishme që të jeni në gjendje t'i identifikoni prindërit e nxënësve tuaj për të biseduar me ta, sidomos gjatë takimeve me prindër. Nëse nëna është plotësisht e mbuluar, mund t'i kërkonit që ta dëshmojë identitetin e saj. Nëse shkolla juaj në përgjithësi nuk lejon mbulimin e fytyrës, mund të flisni me nënën dhe t'i shpjegoni pse mbulesat e plota të fytyrës nuk janë të përshtatshme në shkollën tuaj. Ju mund ta theksoni, për shembull, se këto masa ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së nxënësve prej rreziqeve të kriminelëve të mundshëm, të cilët mund ta përdorin mbulimin e fytyrës me qëllim të lëndimit të nxënësve në mënyrë anonime. Gjithashtu duhet të konsultoheni me drejtorin e shkollës, për t'i mësuar rregullat dhe ligjet ekzistuese të shkollës.

Çfarë mund të bëj nëse një nxënësi/nxënëse vesh rroba të papërshtatshme, nuk dëshiron ose e ka të ndaluar të ndjekë orën e edukatës fizike?

Sfida:

Ka raste kur prindërit i nxisin fëmijët e tyre të mos marrin pjesë në orët e edukatës fizike, sepse kanë shqetësime rreth aktiviteteve të përbashkëta në mes të djemve dhe vajzave si dhe mund të kenë pretendime se veshja sportive nuk është e përshtatshme për fëmijët e tyre.

Mundësitë për veprim:

Në këto raste, mësimmshënësi duhet ta bëjë të qartë se shkolla ka rregullat e veta bazuar në Ligjin e Arsimit Parauniversitar²¹ dhe Udhëzimin Administrativ

21 Kuvendi i Kosovës, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,666>

MASHT Nr. 06/2014 "Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta" ku ceket se një nga veprimet e ndaluara është: "Veshja e uniformës fetare". Ju duhet t'ua shpjegoni se ora e edukatës fizike është e detyrueshme dhe e barabartë me të gjitha lëndët tjera mësimore dhe nxënësi duhet të vlerësohet në të gjitha lëndët e përfshira në kurrikulë.

Ju mund ta theksoni faktin se edhe vendet më konservatore kanë skuadra sportive femërore, që marrin pjesë në gara të niveleve shumë të larta (Lojërat Olimpike etj.). Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në sport, nuk duhet të konsiderohet si problem në shoqërinë e hapur dhe tolerante të Kosovës. Përkundrazi, duhet të inkurajohet; kosovaret kanë treguar tashmë se janë kampione të botës në sporte të ndryshme. Prandaj, duhet t'u shpjegohet nxënësve se ora e edukatës fizike paraqet një mundësi të mirë për të filluar një karrierë në sport. Për më tepër, duhet gjithashtu t'ua shpjegoni se aktiviteti fizik është shumë i rëndësishëm për një mendje dhe trup të shëndoshë. Veshja e papërshtatshme si xhelabijea (që shkon deri në fund të këmbëve) mund t'i pengojë ose t'i rrezikojë nxënësit gjatë orës së edukatës fizike. Mësimdhënësit janë të detyruar që ta ruajnë sigurinë e nxënësve dhe mund të konsiderohen përgjegjës për aksidentet.

Kur diskutimet me prindërit dhe nxënëset e interesuara nuk sjellin ndonjë rezultat, atëherë ju mund të merrni parasysh edhe ndihma nga jashtë, nga shërbimet këshilluese ekzistuese. Gjithashtu, shënojeni incidentin dhe raportojeni tek drejtori i shkollës, sipas rregullave të përcaktuara nga shkol-la. Në shumë raste, refuzimi për të marrë pjesë në orën e edukatës fizike mund të shihet si çështje e parëndësishme dhe nuk raportohet aspak. Meg-jithatë, këto çështje mund të jenë edhe pjesë e procesit të radikalizmit, kështu që mësimdhënësit duhet t'i trajtojnë këto raste me kujdes. Për më tepër, shpërfillja mund të sjellë tolerim të praktikave të cilat i diskriminojnë nxënësit dhe mund të kenë pasoja afatgjata. Për këtë arsye, këto çështje duhet gjithmonë të raportohen.

Çfarë duhet të bëj nëse një nxënës/nxënëse qëndron larg mësimi për të marrë pjesë në faljen e namazit?

Sfida:

Nxënësit në shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta kërkojnë leje për të munguar nga orët, në mënyrë që të mund ta ndjekin namazin. Në aspektin ligjor, nuk bën dallim nëse një nxënës/nxënëse mungon paarsye në

klasë, qoftë për t'u falur apo për ndonjë çështje tjetër, prandaj mësimdhënësit nuk duhet ta aprovojnë kërkesën e nxënësve për të dalë nga ora e mësimi.

Mundësitë për veprim:

Fillimisht, është me rëndësi që nxënësve duhet t'u bëhet e qartë se ju i respektoni pikëpamjet dhe besimin e tyre por nuk mund të lejohet që ata të mungojnë nga mësimi. Kjo vlen për të gjithë nxënësit pa dallim të përkatësisë së tyre fetare.

Poashtu, ju duhet t'i informoni nxënësit se pa marrë parasysh nëse janë në shkollën fillore, të mesme të ulët apo të mesme të lartë, duhet t'i vijnë me rregull të gjitha orët mësimore. Sipas Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 06/2014 "Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta", nuk lejohet mungesa e pajustificuar e vijimit të mësimi nga ana e institucioneve arsimore-mësimore dhe trajnuese.²²

Nëse nxënësit këmbëngulin që të mungojnë nga orët e mësimi, në mënyrë që të mund ta ndjekin namazin, atyre duhet t'ua shpjegoni përfitimet e ndjekjes së orëve të mësimi dhe rëndësinë që do të ketë kjo për të ardhmen e tyre. Duhet të përpiqeni të zhvilloni dialog konstruktiv me nxënësit tuaj, në vend që t'i ndëshkoni. Nëse diskutimi i këtyre pasojave nuk ka efekt, mund t'i përfshini edhe prindërit. Kjo është një mundësi për shërbimet pedagogjike që të krijojnë hapësira të posaçme për diskutim, shkëmbim dhe ndarje të informacionit me prindërit si dhe për përfshirjen e tyre në një diskutim të përgjithshëm për respektimin e rregullave të shkollës. Megjithatë, nëse nuk ka progres ju duhet t'ua rikujtoni pasojat, të cilat mund të përfshijnë efekte negative në notën e tyre në sjelljes, humbjen e ligjëratave të rëndësishme gjë që mund të ndikojë në notat e tyre.

Gjithashtu, duhet të theksoni se shkolla është përfundimisht përgjegjëse për mirëqenien e fëmijëve gjatë orëve të mësimi. Tolerimi i mungesave të tyre mund të ketë pasoja për mësimdhënësit, në rast se ndodh diçka me nxënësit gjatë këtyre orëve. Kjo nuk lidhet me lirinë e besimit, por me rregullat e sistemit arsimor.

22 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr. 06/2014 për Kodin e Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>

Si të reagoj nëse nxënësit agjerojnë gjatë muajit të Ramazanit dhe nuk janë në gjendje të përqendrohen në klasë?

Sfida:

Shumë nxënës/nxënëse në Kosovë e konsiderojnë agjërimin gjatë Ramazanit pjesë të fesë, kulturës apo traditës së tyre dhe duan që shkolla ta kuptojë dhe ta mbështesë këtë. Gjatë ditëve të muajit të Ramazanit, nxënësit nuk hanë dhe nuk pinë asgjë kështu që ata mund të ndjehen shumë të plogësht, ndonjëherë deri në atë pikë sa mund të alivanosen. Madje, ka raste kur në shkollë fillore agjerojnë edhe nxënës shumë të vegjël në moshë.

Mundësitë për veprim:

Nëse është e përshtatshme, ju mund të flisni edhe me prindërit e nxënësve më të vegjël (mosha e shkollës fillore) dhe t'ua shpjegoni atyre se fëmija i tyre është shumë i vogël për të agjëruar gjatë Ramazanit dhe mund të ketë pasojë për shëndetin, nivelin e përqendrimit dhe suksesin në shkollë (detyrat e shtëpisë, periudha e testeve dhe provimeve). Ju mund t'i diskutoni këto çështje me prindërit dhe t'ua sqaroni se mësimdhënësit dhe personeli edukativo-arsimor në përgjithësi janë përgjegjës për mirëqenien e nxënësve përderisa ata janë në orar të mësimt.

Çfarë mund të bëj nëse nxënësit nuk duan ose nuk lejohen të ndjekin një udhëtim shkollor?

Sfida:

Kur organizohen ekskurzione dhe aktivitete të ndryshme shkollore në nivel vendi e më gjerë, disa nxënës mund të deklarojnë se nuk do të marrin pjesë në këto udhëtime. Në shumicën e rasteve këta nxënës nuk paraqesin ndonjë arsye të veçantë për vendimin e tyre, përpos refuzimit që mund të jetë i motivuar nga qëndrimet kulturore, tradicionale dhe religjioze dhe mungesa e vullnetit për të bashkëpunuar me nxënës të tjerë. Megjithatë, mund të jetë edhe fakti që nxënësi/nxënësja është ngacmuar, prindërit janë të shqetësuar për sigurinë ose mirëqenien e tij/saj gjatë udhëtimit, ose prindërve mund t'u mungojnë edhe mjetet financiare për ta dërguar nxënësin në udhëtim. Në veçanti, disa prindër të besimit islam mund të shqetësohen për atë që vajzat dhe djemtë vendosen së bashku, se ushqimi që fëmijët e tyre do ta konsumojnë

(hanë) nuk përputhet me rregullat fetare, ose se ata mund të bien në kontakt me alkoolin dhe drogën.

Mundësitë për veprim:

Mësimdhënësi fillimisht duhet të flasë me nxënësit dhe të përpiqet të gjejë se cilat janë arsyet e tyre dhe të prindërve të tyre. Sapo të keni identifikuar saktësisht fushën e shqetësimit, mund të jetë një ide e mirë të përpiqeni të flisni me prindërit dhe t'i siguroni ata se nxënësit do të jenë nën përkujdesjen e stafit të shkollës. Gjithashtu, mësimdhënësi duhet t'i informojë prindërit se këto aktivitete janë pjesë e planifikimeve shkollore me qëllim të arritjes së rezultateve shkollore.

Me prindërit duhet t'i diskutoni hapur të gjitha këto frika dhe shqetësime dhe, për aq sa është e mundur, së bashku t'i përcaktoni rregullat e udhëtimit dhe aktivitetet e parapara. Për më tepër, duhet t'ua sqaroni prindërve se refuzimi i tyre do ta veçojë fëmijën e tyre nga nxënësit e tjerë të klasës.

Si duhet të angazhohem me nxënësit kur diskutojnë për teoritë e konspiracionit?

Sfida:

Disa nxënës/nxënëse mund të përpiqen të argumentojnë se është detyrë e çdo myslimani të mbështesë luftëtarët e huaj në Siri dhe Irak, sepse pretendojnë se Perëndimi nuk i ndihmon myslimanët, ose se ISIS-i (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë) është krijuar nga superfuqitë botërore, para se të dilte jashtë kontrollit të tyre. Mësimdhënësit, gjithashtu, mund të përballen me raste kur nxënësit pohojnë se "të gjitha konfliktet në botë janë nisur dhe mbështetur nga një grup i vogël hebrenjsh që e kontrollojnë botën". Shumë të rinj gjejnë argumente të tilla në internet, që është një nga metodat kryesore të shpërndarjes së propagandës.

Mundësitë për veprim:

Bota e adoleshentëve dhe të rinjve është e përmbatur nga informacionet dhe pamjet që shpërndajnë teori konspirative. Për t'u përballur me këtë çështje, shkollat duhet që, me forcat e veta ose me ndihmën e partnerëve të jashtëm, të zhvillojnë dhe realizojnë projekte edukative, me të rinjtë për ngjarje

të përzgjedhura nga lajmet. Mësimdhënësit mund të punojnë në analizimin, të kuptuarit dhe kontekstualizimin e informacionit, si pjesë e procesit arsimor (histori, gjeografi, filozofi etj.).

Në të gjitha rastet është e rëndësishme që nxënësit të mos kritikohen menjëherë pse kanë pikëpamje të tilla, duke i detyruar të përvetësojnë një mënyrë tjetër të të menduarit. Edhe pse fillimisht kjo mund ta shuaj hovin e nxënësve në klasë, zakonisht nuk do ta ndryshojë mënyrën se si mendojnë. Përkundrazi, duhet t'i inkurajoni nxënësit tuaj që ta shpjegojnë dhe arsyetojnë qëndrimin e tyre. Nëse jeni të sigurt se ka nxënës që do të shprehin pikëpamje të kundërta, mund të jetë e dobishme t'i lejonit nxënësit të diskutojnë mes tyre. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme të paraqiten informata faktike që ofrojnë një shpjegim alternativ për teoritë e tyre, p.sh. duke u treguar se si lëvizjet humanitare ndërkombëtare si Gjysmëhëna e Kuqe dhe Kryqi i Kuq bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe sa shumë vende me popullatë shumicë krishtere e kanë njohur dhe e përkrahin Kosovën, një vend me shumicë myslimane.

Natyrisht që vende dhe grupe të ndryshme anembanë botës kanë interesat dhe agjendat e tyre, dhe kjo është normale. Duhet të theksoni se është e rëndësishme të njihen/kuptohen këndvështrimet e ndryshme mbi zhvillimet botërore, por lajmet e rreme dhe teoritë konspirative po e shtrembërojnë të vërtetën, duke fajësuar disa shtete ose grupe fetare për gjithçka. Ju duhet të theksoni se nuk mund t'i zgjidhim çështjet lokale, kombëtare apo globale nëse e injorojmë të vërtetën dhe thjesht i fajësojmë të tjerët.

Ju gjithashtu mund të theksoni se diskriminimi dhe ksenofobia janë çështje problematike botërore, që i prekin komunitetet, kulturat dhe fetë e ndryshme, jo vetëm myslimanët. Anti-semitizmi në veçanti është i përhapur dhe hebrenjtë kanë qenë objektivi i diskriminimit për shumë mijëvjeçarë. Është e rëndësishme të sqaroni se të gjitha diskriminimet janë të gabuara, pavarësisht se kush i kryen apo kundër kujt drejtohen. Është e nevojshme të luftohet diskriminimi dhe ksenofobia, por kjo duhet të bëhet pa akuzuar grupe të caktuara etnike dhe fetare. Gjatë këtij diskutimi, ju gjithashtu mund të theksoni sa e dëmshme është 'gjuha e urrejtjes'²³ për komunitetet dhe pse duhet të shmanget.²⁴

23 The Council of Europe (2015) Teaching Controversial Issues Through Education for Democratic Citizenship and Human Rights (EDC/HRE), Training pack for teachers: <https://rm.coe.int/16806948b6>.

24 Manual on hate speech, Council of Europe: <https://rm.coe.int/1680665b3f>

Si duhet të reagoj nëse një nxënës/nxënese thotë: "Unë nuk pranoj asgjë tjetër përveç Kuranit!" apo edhe refuzon të marrë pjesë në orët mësimore përmbajtja e të cilave mund të bie ndesh me pikëpamjet e caktuara kuranore?

Sfida:

Nxënësi refuzon të flasë për çështje që nuk janë në përputhje me Kuranin. Edhe ora e muzikës mund të çojë në mosmarrëveshje me nxënësit dhe/ose prindërit e tyre, nëse e interpretojnë Kuranin në një mënyrë që e ndalon muzikën.

Mundësitë për veprim:

Diskutimi i pyetjes "Si duam të jetojmë?" mund të ndihmojë në menaxhimin e këtyre situatave. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet vlera e tolerancës reciproke në mes të këndvështrimeve intelektuale, kulturave dhe feve të ndryshme. Nxënësit duhet të sigurohen nga fakti se çdo identitet meriton të respektohet dhe të kuptojnë se, për ta bërë këtë, është shumë e rëndësishme që të gjithë t'i respektojnë rregullat e shkollës.

Ju duhet të theksoni se shkolla u mëson nxënësve të mendojnë në mënyrë analitike dhe kritike, në mënyrë që të mund të dallojnë në mes të mirës dhe të keqes. Ata mund të zgjedhin të besojnë ose jo në gjëra të caktuara, por është shumë e rëndësishme që të jenë të hapur ndaj informacioneve të ndryshme dhe kjo nuk mund të arrihet duke i injoruar gjërat. Duhet të jemi mendje hapur që të ecim përpara. Natyrisht që besimi në një fe të caktuar nuk bie ndesh me këtë.

Për më tepër, pluralizmi mund të konsiderohet si pasuri e shoqërisë. Republika e Kosovës është shtet laik, që garanton lirinë fetare dhe askush nuk mund ta detyrojë dikë tjetër që t'i përshtatë mendimet e veta me një besim të caktuar fetar.

Nëse dialogu nuk funksionon, duhet të zbatohen masa disiplinore të përcaktuara me rregullore, ndaj nxënësve, sjellja e të cilëve nuk është në përputhje me këto rregulla dhe prindërit duhet të përfshihen në dialog atëherë kur është e nevojshme.

Si mund ta trajtoj një situatë në të cilën një nxënës/nxënese ka qenë nën presion nga shokët/shoqet e klasës për ta ndryshuar qasjen ndaj fesë , d.m.th. të bëhet më fetar?

Sfida:

Ka pasur situata në të cilat nxënësit i bëjnë presion njëri-tjetrit për ta ndryshuar qasjen ndaj fesë, ose ndoshta të bëhen më fetar. Për shembull, gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, nxënësit që agjërojnë u bëjnë presion bashkëmoshatarëve dhe mësimdhënësve të tyre të fillojnë të agjërojnë ose i akuzojnë se nuk janë besimtarë të vërtetë.

Mundësitë për veprim:

Nëse vëreni një nxënës/nxënese duke i detyruar bashkëmoshatarët që ta ndryshojnë qasjen e tyre ndaj fesë, duhet të ndërhyni menjëherë. Përpiquini maksimalisht që t'i theksoni përfitimet që sjell diversiteti dhe toleranca në një shoqëri moderne si dhe shpjegoni dhe diskutoni me nxënësit domethënien e diversitetit dhe tolerancës.

Ju, gjithashtu, mund ta shpjegoni kuptimin e lirisë fetare dhe laicizmit dhe pse ato janë të dobishme për shoqëritë tona. Liria e fesë nuk mbron vetëm ata që dëshirojnë të praktikojnë fenë e tyre, por edhe ata që nuk duan ta praktikojnë. Feja nuk është diçka që duhet t'ia imponojmë të tjerëve. Ju mund t'i pyetni nxënësit tuaj si do të ndiheshin nëse dikush nga një fe tjetër do të përpiquej t'ua impononte ose ndalonte fenë e tyre. Ju mund t'i mësoni nxënësit për ndjeshmërinë dhe arsyen pse ajo është shumë e rëndësishme.

Megjithatë, si pjesë e reagimit tuaj është që ju duhet ta informoni administratën e shkollës apo drejtorin lidhur me këtë çështje, si dhe duhet të kontaktohen prindërit e të dy nxënësve në lidhje me rastin.

Çfarë duhet të bëj nëse një nxënës/nxënese miraton sulmet terroriste?

Sfida:

Ka pasur incidente ku pas një sulmi terrorist, për të cilin një grup esktrmist e ka marrë përgjegjësinë, një nxënës njofton në klasë se "jobesimtarët meritonin" sulmin për shkak të stilit të jetesës së tyre dhe/ose sepse "Perëndimi i ka shtypur myslimanët".

Mundësitë për veprim:

Kjo deklaratë mund të jetë vetëm provokim, por gjithashtu mund të bazohet në besimin vetanëk fetar të nxënësit ose në pikëpamjen e ofruar nga familja e tij/saj ose nga rrethi i afërt. Sfidoni deklaratën e nxënësit. Kërkojuni atyre të shpjegojnë pse ata mendojnë kështu. Përdorni listën e shenjave identifikuese në fillim të doracakut për të hetuar nëse ky mund të jetë një rast i radikalizmit. Gjithashtu, inkurajoni nxënësit tjerë që me argumente ta debatojnë deklaratën dhe t'i nxjerrin në pah të metat e saj.

Është e rëndësishme që gjatë këtyre diskutimeve të tregoni ndjeshmëri, duke theksuar se viktimat e sulmeve terroriste janë njerëz të pafajshëm, të ngjashëm me ju dhe nxënësit që po mësoni. Për më tepër, gjatë sulmeve terroriste janë vrarë edhe njerëz të përkatësisë islame (në Perëndim, por kryesisht në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe Afganistan). Secili prej nesh, familjet tona dhe njerëzit tanë të afërt mund të jenë viktimat e sulmeve terroriste një ditë. Asgjë nuk mund ta justifikojë vrasjen e njerëzve të pafajshëm.

Prindërit dhe administrata e shkollës duhet të informohen nëse ka arsye për shqetësim.

Ç'duhet të bëj nëse një nxënës/nxënëse viziton një institucion fetar, që dyshohet se aty predikohen ligjërime radikale?

Sfida:

Një nxënës/nxënëse mund të vizitojë një institucion fetar, në të cilën ju keni frikë se komunikohet një interpretim radikal ose problematik i Islamit. Ky nuk është detyruesisht tregues i radikalizmit, por mund të jetë shkak për shqetësim.

Mundësitë për veprim:

Shumë të rinj në mbarë botën, duke përfshirë edhe Kosovën, janë indoktrinuar dhe janë rekrutuar si luftëtarë të huaj nga klerikët radikal. Së pari, duhet të siguroheni se informacionet mbi qasjen radikale në një xhami janë të sakta. Para se ta sfidoni nxënësin, është mirë që të përpiqeni ta zhvilloni një dialog konstruktiv, sepse reagimi i tepruar mund të ketë kundër-efekt. Në ndërkohë, ju duhet ta njoftoni drejtorin si dhe prindërit nëse këtë e vlerësoni si të

nevojshme. Paraprakisht, ju gjithashtu mund ta diskutoni situatën dhe shqetësimet tuaja edhe me kolegët. Nëse vazhdoni të dyshoni, mund të vendosni që çështjen t'a diskutoni edhe me Policinë e Kosovës.

A ka mënyra të caktuara të sjelljes apo shenja që do të tregonin nëse një nxënës/nxënëse po radikalizohet?

Sfida:

Mësimdhënësit i vërejnë ndryshimet në sjelljet e nxënësve të tyre. Sfida është se ndonjëherë mësimdhënësit nuk mund ta dallojnë nëse sjelljet janë shenja që tregojnë se një nxënës/nxënëse po radikalizohet.

Mundësitë për veprim:

Mënyrat e radikalizmit ndryshojnë dhe janë specifike në secilin rast, megjithatë, edhe pse nuk ka një proces të vetëm të radikalizmit, ka mënyra të sjelljes, shprehjeve dhe karakteristikave që mund të shërbejnë si tregues për një zhvillim apo avancim të radikalizmit tek nxënësit. Ne kemi mbledhur disa shenja identifikuese të cilat janë prezantuar në fillim të këtij doracakut. Në shumicën e rasteve, një rritje e mundshme e radikalizmit mund të identifikohet vetëm kur disa tregues paraqiten në të njëjtën kohë. Nëse ju vëreni vetëm një tregues kjo mund të jetë veprim i momentit si rezultat i provokimeve të ndryshme të nxënësve. Prandaj, gjatë vlerësimit të një nxënësi ju duhet që t'i përfshini edhe kolegët tuaj të cilët gjithashtu e njohin atë, për të marrë mendime të tjera.

Kur ju e vëzhgoni një tregues të radikalizmit, qasja më e mirë është që t'i afroheni nxënësit për një dialog konstruktiv në mënyrë që ta kuptoni arsyen e paraqitjes së atij treguesi. Zbulimi i shenjave të hershme të radikalizmit mund ta parandalojë radikalizmin e nxënësit dhe ta mbrojë atë nga pasojat e ndryshme.

Thirrja para kohe e policisë mund të jetë kundër-produktive. Kjo duhet të konsiderohet si veprim i fundit.

Si mund ta dalloj radikalizmin nga të praktikuarit e thjeshtë të fesë?

Sfida:

Në disa situata, mund të mos jetë e lehtë të kuptohet drejtpërdrejt nëse një nxënës e praktikon fenë e vet në një mënyrë shumë konservatore, apo interpretimi i tij ose i saj tashmë përfshin edhe akuzën ndaj të tjerëve si jo-besimtarë ose është tërësisht i mbyllur në botëkuptimet e tij/saj.

Mundësitë për veprim:

Përpiquni të flisni me akëcilin nxënës, kërkonti këshilla nga kolegët tuaj që gjithashtu i japin mësim këtij nxënësi dhe përpiquni ta vlerësoni së bashku situatën. Në këtë rast, diskutimi në klasë mund të sjellë rezultate, pasi diskutimi ndërmjet bashkëmoshatarëve mund të jetë më efektiv. Në shumicën e rasteve, gjatë këtyre bisedave nxënësit do të shprehin mendime që i pasqyrojnë ideologjitë në të cilat besojnë.

Duhet ta shqyrtoni listën e shenjave identifikuese në fillim të doracakut. Shenja të caktuara, si justifikimi i dhunës ose promovimi i qëndrimit "ne" kundër "atyre", duke i përshkruar "të tjerët" si armiq, duhet të shqyrtohen nga afër. Ideologjitë radikale zakonisht përdorin fenë për t'i justifikuar agjendat e tyre të dhunshme. Kur flisni me nxënësin tuaj, përpiquni t'i identifikoni dhe t'i vëzhgoni shenjat e indoktrinimit ideologjik, si dhe burimet e referencave dhe interpretimeve të tij/saj fetare.

Ç'duhet të bëj nëse një nxënës/nxënëse shkëmben propagandë ekstremiste fetare me nxënësit e tjerë?

Sfida:

Një mësimdhënës e vëren nëse një nxënës/nxënëse po u tregon shokëve/shoqeve të klasës materiale propaganduese ekstremiste fetare brenda hapësirave shkollore.

Mundësitë për veprim:

Ju mund ta trajtoni çështjen e 'propagandës' në të njëjtën mënyrë si kur flisni me nxënësit tuaj rreth teorive të konspiracionit, duke e inkurajuar diskutimin

në klasë dhe të menduarit kritik. Megjithatë, nëse këto materiale propaganduese përmbajnë ose nxisin dhunë duhet të jeni të vetëdijshëm se shpërndarja e tyre është një vepër penale. Në raste të tilla, duhet ta përfshini administratën e shkollës dhe ta kontaktoni policinë. Është e mundur që nxënësi të jetë radikalizuar dhe që po përpiqet t'i rekrutojë shokët/shoqet e klasës. Megjithatë, është gjithashtu e mundur që nxënësi të jetë i joshur nga prezantimi i materialeve dhe dhuna që ato përmbajnë (pasi këto materiale shpesh i ngjajnë video-lojërave) dhe mendon se është "interesante" që të paraqesë materiale të tilla për shokët/shoqet e klasës.

Prezantimi i materialeve të tilla dhe përpjekja e rekrutimit përmes shpërndarjes së këtyre materialeve mund të kenë pasoja serioze për nxënësit dhe shkollën tuaj duke pasur parasysh se shumë luftëtarë të huaj të rinj në moshë janë rekrutuar nga miqtë e tyre të ngushtë dhe shokët/shoqet e klasës.

Çfarë duhet të bëj nëse persona të dyshimtë përpiqen t'i kontaktojnë nxënësit para shkollës?

Sfida:

Ju vini re se aktivitete të dyshimta të rekrutimit dhe persona të dyshimtë sillen në afërsi të shkollës.

Mundësitë për veprim:

Pas konsultimit me administratën e shkollës, kontaktoni prindërit dhe policinë. Siguria e nxënësve mund të jetë në rrezik. Shumë grupe kriminale dhe radikale i shohin të rinjtë si burime potenciale njerëzore për realizimin e qëllimeve të tyre. Është përgjegjësi e juaja që t'i mbronin nxënësit nga përpjekje të tilla.

Çfarë duhet të bëj nëse një nxënës/nxënëse nuk vjen më në klasë dhe jam i/e shqetësuar sepse mund të jetë duke e menduar largimin, ose madje duke e planifikuar largimin nga vendi?

Sfida:

Keni frikë se një nxënës/nxënëse është vetë-tërhequr nga komuniteti i shkollës. Ndoshta keni edhe prova konkrete se ata janë gati të largohen nga vendi për t'iu bashkuar një konflikti të huaj.

Mundësitë për veprim:

Në fillim duhet t'i kontaktoni prindërit. Së bashku me prindërit dhe administratën e shkollës mund që të kërkonit ndihmë edhe nga shërbimet mbështetëse në shkollë dhe jashtë saj si p.sh. psikologu, shërbimet pedagogjike, Qendra për Punë Sociale, Qendra e Mjekësisë Familjare, Policia e Kosovës dhe shërbimet tjera konkrete. Gjithashtu, rreziqet e braktisjes së shkollës identifikohen me instrumentet e përcaktuara në doracakun për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në nivel shkolle. Përgjatë procesit të parandalimit të braktisjes mund të identifikohen edhe shenjat e radikalizmit.

Nëse një nxënës/nxënëse e raportoni tek autoritetet, kjo nuk nënkupton që e keni vënë atë në rrezik, por e kundërta. Ju po e mbroni atë, sidomos nëse ai/ajo është i/e mitur. Për më shumë, si rezultat i raportimit tuaj ju jeni duke e mbrojtur edhe rrethin e tij/saj (familjen dhe miqtë). Ta denoncosh dikë nuk nënkupton që jeni duke bërë thjeshtë akuzë formale kundër dikujt, por jeni duke ndihmuar në parandalimin e rrezikut.

Si duhet të reagoj kur një nxënës/nxënëse e sheh shtetin laik si kërcënim?

Sfida:

Një nxënës/nxënëse e sheh shtetin laik si kërcënim për mënyrën e vet të jetesës, duke pretenduar se shteti duhet të udhëhiqet në bazë të besimeve fetare.

Mundësitë për veprim:

Mësimdhënësi duhet t'ua sqaroj nxënësve se "Republika e Kosovës është një shtet laik dhe është neutral në çështjet e besimeve fetare". Por gjithashtu thekson se: "Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë përfshin të drejtën për ta pranuar dhe manifestuar fenë, të drejtën për t'i shprehur bindjet personale dhe të drejtën për ta pranuar ose refuzuar anëtarësimin në një komunitet ose grup fetar".²⁵

Ju duhet t'ua shpjegoni nxënësve se të drejtat e secilit janë të garantuara me Kushtetutë, e cila është akti më i lartë juridik i një shteti dhe për këtë arsye nuk paraqet kërcënim për askë. Shteti laik e garanton lirinë e fesë dhe i mbron të drejtat e të gjithëve në vend dhe falë kësaj të gjithë besimtarët e feve të ndryshme e praktikojnë fenë e tyre.

Çfarë duhet të bëj nëse një nxënës/nxënëse nuk pajtohet që shkollat të kenë ditë pushimi për festat e feve të tjera?

Sfida:

Një nxënës/nxënëse, ose një grup nxënësish, janë kundër ditëve të pushimit nga shkolla për festa të feve të tjera. Ata mund të pretendojnë se si besimtarë që janë të një feje i tolerojnë fetë e tjera, por nuk kanë nevojë t'i festojnë festat e tyre, duke pasur ditë pushimi nga shkolla.

Mundësitë për veprim:

Mësimdhënësi duhet t'ua sqarojë nxënësve se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut. Çdo vit, duke i respektuar të gjitha komunitetet në Kosovë, Qeveria e Kosovës e publikon "Kalendarin e Festave Zyrtare", për kremtimin e festave të të gjitha grupeve fetare në Kosovë. Ju duhet t'ua shpjegoni nxënësve se ata mund të mos i festojnë festat e feve të tjera, por duhet t'i respektojnë të tjerët, në mënyrë që të kenë respekt të ndërsjellë dhe mirëkuptim fetar ndaj njëri-tjetrit.

Ajo çfarë bën Kosova është model për shumë vende të botës dhe ata duhet të inkurajohen që të krenohen me këtë fakt.

25 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 8 dhe 38 [Shteti laik].
<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

Si mund të ofrojë shkolla një mundësi të sigurt dhe të hapur për dialog dhe diskutim mbi çështjet e lidhura me ekstremizmin e dhunshëm e që konsiderohen të ndjeshme politikisht nga komuniteti apo vendi?

Sfida:

Disa mësimdhënës hezitojnë të diskutojnë me nxënësit në klasë për çështje që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm për shkak të ndjeshmërisë së temës apo sepse nuk kanë informata të mjaftueshme dhe shkathtësi për t'u marrë me këtë çështje. Frika është gjithashtu se çështjet e ndjeshme mund të përshkallëzojnë në debate politike.

Mundësitë për veprim:

Nxënësit kanë nevojë për një vend të sigurt ku mund t'i adresojnë çështjet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë edhe ato tema që konsiderohen "tabu". Për ta parandaluar përshkallëzimin e diskutimeve mbi çështje të ndjeshme në debatet politike, që në fillim çështjet duhet të parashtrohen qartë dhe t'i shërbejnë një qëllimi të caktuar. Për shembull, në qoftë se ka një konflikt në mes të grupeve të caktuara etnike të pranishme në komunitet, duhet t'i qasemi temës duke e filluar diskutimin mbi "dialogun ndër-kulturor" dhe "të mësuarit për të jetuar së bashku". Të kuptuarit e konceptit nga ana e nxënësve mund të përshpejtohet në qoftë se përdorni shembuj të ndryshëm nga vendi. Fillimi i diskutimit duhet t'i shërbejë objektivit specifik të të mësuarit, e jo çështjes së ndjeshme e cila diskutohet, dhe e cila duhet t'i shërbejë qëllimit parësor. Kjo mund të ndihmojë e ta parandalojë diskutimin që mos të kalojë në debate politike dhe që përqendrimi të mbetet në procesin e mësimi.²⁶

Pse përfshirja ime si mësimdhënës është me rëndësi për shkollën?

Sfida:

Ndonjëherë mësimdhënësit mendojnë se roli i tyre është që të përqendrohen vetëm në diskutime rreth lëndës së tyre dhe jo të përfshihen në diskutime të tjera profesionale që lidhen me çështjet e jetës së përditshme. Ndonjëherë është e vështirë për mësimdhënësit që të përfshihen në pikëpamjet dhe veprimet personale të nxënësit.

²⁶ UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulture e Kombeve të Bashkuara. Udhëzuesi për mësimdhënës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.. 2016. P.13.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

Mundësitë për veprim:

Roli i mësimdhënësit ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë. Nuk do të ishte e ekzagjeruar nëse themi se mësimdhënësit kontribuojmë shumë më shumë se sa vetëm në ofrimin e njohurive për nxënësit në lëndët e tyre. Këto biseda mund të nxiten nga vetë mësimdhënësit ose mund të lindin në mënyrë spontane. Kjo kërkon që mësimdhënësit të përdorin role dhe qasje të ndryshme; p.sh. rolin e udhëheqësit neutral, "mikut kritik" apo rikujtimin e linjës zyrtare. Ky rol i ri i mësimdhënësve karshi nxënësve të tyre nuk është i rëndësishëm vetëm për parandalimin e radikalizmit por edhe për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm. Nxënësve duhet t'u jipet mundësia për të folur, për të dëgjuar dhe për të dialoguar ashtu që të ndjehen të përfshirë dhe të besojnë se mendimet e tyre janë marrë parasysh. Nxënësit duhet ta kuptojnë se për të funksionuar në një shoqëri demokratike duhet të respektohet mendimi ndryshe.²⁷

A duhet të përqëndrohet diskutimi vetëm në një rast/lloj të ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal?

Sfida:

Ndonjëherë është e vështirë për mësimdhënësit që diskutimet e tyre t'i fokusojnë rreth shembujve lokal të ekstremizmit të dhunshëm për shkak të rrezikut që mund të bartin ata në ndërtimin e stereotipeve për grupe/popullsi të caktuara.

Mundësitë për veprim:

Përfshirja e shembujve lokal të ekstremizmit gjatë diskutimeve në klasë mund të ndihmojë për ta bërë temën më të prekshme nga nxënësit, por edhe mund të çojë në rritjen e ngarkesave emocionale dhe të stresit tek ata. Përveç kësaj ekziston edhe rreziku i etiketimit të grupeve të caktuara të nxënësve, për këtë arsye është e rëndësishme që kjo çështje të trajtohet në mënyrë të baraspeshuar e të kujdesshme.

Si ilustrim, për këtë temë, mësimdhënësit mund të përdorin edhe shembuj të ekstremizmit të dhunshëm nga tekstet shkollore të vendeve të tjera të botës. Kur trajtohet një situatë lokale e ekstremizmit të dhunshëm, mësimdhënësi mund ta trajtojë atë në nivelin konceptual, duke iu referuar shkaqeve

27 RAN Paper, Fuqizimi i mësuesve, 2016

dhe shtytësve të ndryshëm që kanë çuar në një ekstremizëm të dhunshëm dhe për pasojat e mundshme të tij. Kjo do t'u ndihmonte nxënësve që të distancohen emocionalisht dhe fizikisht nga çështja/rasti në mënyrë që ta shmangin përfshirjen personale në trajtimin e saj gjë që do ta pengonte debatin e hapur dhe konstruktiv.

Pasqyra e iniciativave parandaluese në Kosovë

Iniciativat në nivel qendror

Në vitin 2015, si përgjigje ndaj kërcënimeve globale të ekstremizmit të dhunshëm dhe rritjes së kësaj dukurie në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë Kombëtare “Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020” dhe Planin e Veprimit. Strategjia e ka përpiluar planin e veprimit si dhe për secilin institucion janë definuar rolet që i kanë në monitorim dhe vlerësim.

Zyra e Kryeministrit- e mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Zyra e Kryeministrit e kryeson Grupin Punues Qeveritar dhe sipas nevojës edhe Grupin/grupet Punuese Teknike të cilat themelohen për Strategjinë dhe Planin e Veprimit. Zyra e Kryeministrit në bashkëveprim me Ministrinë e Financave do të sigurojë që këto mekanizma ta kenë përkrahjen e nevojshme për kryerjen e punës së tyre.

Koordinatori Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm – për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm. Koordinatori nacional do të jetë këshilltari për siguri i kryeministrit, i cili do ta ketë rolin kryesor në koordinimin e implementimit të Strategjisë. Ai i ka këto detyra dhe përgjegjësi: Këshillon Kryeministrin lidhur me ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe luftën kundër terrorizmit si dhe çështjet e ndërlidhura të sigurisë nacionale; Udhëheq grupin punues qeveritar për hartimin dhe rishikimin e strategjisë dhe planit të veprimit; Koordinon implementimin e Strategjisë Nacionale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm; Është pikë kontakti dhe koordinimi me

donatorët sa i përket implementimit të aktiviteteve të ndërlidhura me implementimin e strategjisë; Bashkëpunon ngushtë dhe i koordinon përpjekjet me qeverinë, ministrinë, misionet dhe organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile, bashkësitë fetare, institucionet e sigurisë dhe inteligjencës dhe akterët tjerë relevant;

Grupi Punues Qeveritar -është përgjegjës për hartimin, rishikimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Grupi do t'ia paraqesë propozimet për miratim Qeverisë së Republikës së Kosovës. Përbërja e grupit punues përcaktohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Përveç përfaqësuesve të Ministrive dhe agjencive relevante të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës, në grupin punues qeveritar duhet të marrin pjesë edhe përfaqësues të Bashkësive fetare, mediave, OJQ-ve, si dhe në cilësinë e vëzhguesve dhe ekspertëve në grupin punues do të ftohen edhe përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtar duke përfshirë Ambasadën e SHBA-së, UNDP-në, OSBE-në, ICITAP (Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Kriminale), EULEX (Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit), Ambasadat tjera sipas interesimit të tyre dhe ekspert të tjerë vendor dhe ndërkombëtar. Grupi Punues Qeveritar duhet ta sigurojë pjesëmarrjen e institucioneve relevante në hartimin, implementimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë do të shërbejë si sekretariat përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Ai është përgjegjës për ta ndihmuar Koordinatorin Nacional dhe Grupin Punues Qeveritar në implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Ai do t'i përgatisë gjetjet dhe propozimet me shkrim lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Sekretariati do ta përdor materialin e mbledhur për Grupin Punues Qeveritar i cili do të vendosë për veprime të mëtejshme. Përfaqësuesit e institucioneve të përfaqësuara në grupin punues Qeveritar duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Sekretariatën në monitorimin e implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit si dhe në rishikimin e tyre.

Grupi/grupet Teknike Punuese- mbështesin Sekretariatën dhe Grupin Punues Qeveritar në hartimin, rishikimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Përgjegjësia e tyre është t'i ofrojnë procesit mendime të ekspertëve. Anëtarët e Grupit Punues Teknik duhet të veprojnë si pika kontaktuese të institucioneve që përfaqësojnë, dhe të jenë në kontakt të rregullt me Sekretariatën dhe anëtarët e Grupit Punues Qeveritar. Ata

duhet t'i ofrojnë Sekretariatit informata të nevojshme për monitorimin e implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.

Iniciativa në nivel lokal

Mekanizmi Referues, i themeluar në prill të vitit 2016 nga Komuna e Gjilanit dhe mbështetur nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetime Penale (ICITAP), miraton një qasje gjithëpërfshirëse për përfshirjen e komunitetit dhe patrullimin në komunitet, duke përfshirë të gjithë sektorët e shoqërisë. Mekanizmi referues funksionon në kuadër të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet autoriteteve lokale, Policisë dhe komuniteteve lokale për të:

(1) pranuar rekomandime për njerëzit në rrezik nga ekstremizmi i dhunshëm, (2) vlerësuar natyrën dhe masën e këtij rreziku, dhe (3) zhvilluar pako më të favorshme mbështetëse.

Referencat

Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 'Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015-2020 (Shtator 2015)

UNDP, Faktorët shtytës dhe tërheqës në Kosovë, 2017 fq.7

http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PVE/UNDP_Push%20and%20Pull%20Factors_ENG.pdf

Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzues për mësimdhënësit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. 2016. fq. 13.

Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 'Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015-2020 (Shtator 2015)

Konventa për të Drejtën e Fëmijëve

UNESCO. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara. Udhëzues për mësimdhënësit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. 2016

UNDP-USAID Raporti i Pulsit Publik- PVE, 2017

Deklarata Universale për të drejtat e njeriut

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

UNESCO Deklarata Universale për diversitetin kulturor UNESCO:

Diversity and Pluralism – How can people live together peacefully?

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Udhëzimi

Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Nr. 06/2014 për Kodin e Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>

Hate Speech Explained' – A Tool Kit, Article 19, 2015

Manual on hate speech, Council of Europe

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

RAN Paper, Fuqizimi i mësuesve, 2016

Shtojcat

Shtojca A Parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve

Parimet e përgjithshme nga Doracaku për Zbatimin e Rregullores Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar.

Mbrojtja ndaj dhunës

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për t'u mbrojtur nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar fëmija.

Interesat më të mira të fëmijës

Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, përfshirë edhe ato veprime që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë një konsideratë mbizotëruese.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit

Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar dhe shteti i merr të gjitha masat e mundshme për ta siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës në shkallën më maksimale të mundshme.

Mos-diskriminimi

Të gjithë fëmijët pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve të tij apo përfaqësuesve ligjor, duhet të mbrohen kundrejt të gjitha llojeve të dhunës dhe t'u sigurohet kujdesi dhe ndihma e nevojshme që e garanton shkallën maksimale të mundshme për mbijetesë dhe për zhvillimin e tyre.

Pjesëmarrja e fëmijëve

Fëmijët kanë të drejtë të shprehen lirisht për të gjitha çështjet që ndikojnë në jetën e tyre, dhe, pikëpamjeve të tyre duhet t'u kushtohet vëmendja e duhur në varësi të moshës dhe pjekurisë së fëmijës.

Shtojca B Raportimi i rasteve të dhunës në institucionet e arsimit para-universitar

Neni 19 Detyrimi për të raportuar dhunën

1. Çdo zyrtar publik apo qytetar që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik, obligohen që menjëherë ta raportojnë rastin në Policinë e Kosovës. Rregullore qrk- Nr. 21/2013 14 Për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar 2. Dështimi të veprohet në këtë mënyrë i nënshtrohet ndjekjes penale sipas ligjeve në fuqi.

Neni 20 Detyrimi për ta raportuar dhunën në institucionet edukativo-arsimore 1. Çdo nxënës, mësimdhënës, udhëheqës, prind dhe punonjës tjetër në një institucion arsimor që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se fëmiju vuan ose është viktimë e ndonjë forme të dhunës të përshkruar në Nenin 2 të këtij Protokollit duhet ta raportojë menjëherë rastin në drejtori të shkollës.

Kapitulli XI PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË RASTIT TË DHUNËS NË SHKOLLË DHE REFERIMI TEK INSTITUCIONET TJERA PËRGJEGJËSE

Neni 21 Procedura e zgjidhjes së rastit të dhunës në shkollë 1. Të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkollë duhet të shqyrtohen menjëherë nga drejtori i institucionit të arsimit para-universitar, duke pasur parasysh çdo herë interesin më të mirë të fëmijës. 2. Institucionet arsimore duhet të trajtojnë rastin deri në zgjidhjen e tij, duke pasur kujdes që realizimi i të drejtave të fëmijëve të mos jetë në dëm të të drejtave të personave të tjerë dhe as në kundërshtim me interesat publike të përcaktuara me ligjet në fuqi. 3. Institucionet arsimore duhet t'u japin hapësirë dhe t'i dëgjojnë të gjitha palët e përfshira në rast që ata të kenë mundësi të deklarojnë mbi faktet dhe rrethanat e rastit, e që janë me rëndësi për marrjen e vendimit nga institucionet

arsimore për zgjidhjen e rastit brenda institucionit. 4. Drejtori i institucionit të arsimit para-universitar cakton menaxherin/përgjegjësin e rastit, që do të jetë përgjegjës për ta përcjellë rastin deri në mbyllje, ndërsa me trajtimin e vet rastit merren ekipet profesionale adekuate. 5. Institucioni i arsimit para-universitar në bashkëpunim me institucionet tjera qeveritare dhe jo qeveritare krijon mekanizmin e ndërmjetësimit jo formal ndërmjet bashkë-moshatarëve si metodë për zgjidhjen e konfliktit të shkaktuar si rezultat i dhunës. 6. Pala e cila konsideron se me anë të vendimit të marrë nga organet e institucionit të arsimit para-universitar i janë shkelur të drejtat e garantuara mund të ankohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 22 Referimi i rastit në Policinë e Kosovës 1. Institucioni i arsimit para-universitar duhet ta referojë rastin në Polici pa deklaratën paraprake të palëve në rastet kur ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë apo dëshmitar i veprës penale, kur është në interesin më të mirë të fëmijës dhe kur intensiteti i dhunës dhe nevoja për ndërhyrjen e Policisë së Kosovës është e domosdoshme. Rregullore qrk- Nr. 21/2013 15 Për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar 2. Referimi i rastit të dhunës në Polici mund të bëhet gojarisht apo përmes telefonit ose mjeteve tjera telekomunikuese. Pas referimit të rastit drejtori i shkollës duhet ta plotësojë formularin përkatës nga shtojca 1 e këtij Protokolli dhe të njëjtin ta dërgoj në polici. 3. Polici që merret me rastin duhet të veprojë menjëherë në përputhje me procedurat e parapara ligjore.

Neni 23 Referimi i rastit në Qendrën për Punë Sociale 1. Institucioni i arsimit para-universitar duhet ta referojë rastin e dhunës në Qendrën për Punë Sociale kur vinë në dijeni se fëmiju ka nevojë për mbrojtje dhe trajtim nga shërbimet profesionale sipas mandatit të përcaktuar me ligj. 2. Referimi i rastit në QPS duhet të bëhet me shkrim (duke plotësuar formularin përkatës nga shtojca 1 e këtij Protokolli) menjëherë pasi të vijmë në dijeni se fëmiju ka nevojë për mbrojtje sociale. 3. Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimin të rastit, duhet ta njoftojë me shkrim drejtorin e institucionit të arsimit para-universitar për veprimet që janë ndërmarrë për t'i dalë në ndihmë fëmijut. Me pranimin e informatave nga QPS vlerësohet statusi i rastit (hapur/mbyllur).

Neni 24 Referimi i rastit në Qendër të Mjekësisë Familjare 1. Institucioni i arsimit para-universitar duhet të referojë rastin e dhunës në Qendër të Mjekësisë Familjare kur vijnë në dijeni se fëmiju ka nevojë për trajtim nga

shërbimet shëndetësore sipas mandatit të përcaktuar me ligj. 2. Referimi i rastit në Qendër të Mjekësisë Familjare duhet të bëhet me shkrim (duke plotësuar formularin përkatës nga shtojca 1 e këtij Protokolli) menjëherë pasi të vijë në dijeni se fëmiu ka nevojë për trajtim/kurim shëndetësor. 3. Institucioni shëndetësor, menjëherë pas ofrimit të shërbimit duhet ta njoftojë me shkrim drejtorin e institucionit arsimor për veprimet që janë ndërmarrë për t'i dalë në ndihmë fëmiut. Me pranimin e informatave nga QMF vlerësohet statusi i rastit (hapur/mbyllur). 4. Të njëjtat procedura të veprimit të përcaktuara për QMF vlejné edhe për rastet për trajtim në Qendrat e Emergjencës dhe Qendrat tjera të ofrimit të ndihmës shëndetësore.

Shtojca C Dokumentet dhe korniza ligjore

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që shpie në Terrorizëm (2015-2020)

Strategjia përcakton tri burime kryesore të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë: ekstremizmi i bazuar në nacionalizëm, ekstremizmi i motivuar nga ana fetare dhe ekstremizmi i motivuar politikisht. Strategjia i ndan këto kërcënime në ato që rrjedhin nga brenda Kosovës dhe ato që rrjedhin nga jashtë vendit. Ndër kërcënimet që strategjia identifikon janë aktivitetet potenciale të grupeve nacionaliste serbe në pjesën veriore të Kosovës dhe fakti që një numër i qytetarëve të Kosovës janë bashkuar me grupet terroriste të motivuara nga feja në Irak dhe Siri. Strategjia gjithashtu thekson se kërcënimet e një natyre të ngjashme mund të vijnë edhe nga vendet fqinje, duke pasur parasysh se jo të gjitha vendet në rajon po ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar grupet e mundshme ekstremiste të dhunshme brenda territorit të tyre.

Ekstremizmi me motive fetare merr vend qendror në strategji, pavarësisht se vërehen nivele të larta të tolerancës fetare në Kosovë. Dokumenti rendit faktorët kryesorë që shpiejnë drejt ekstremizmit të dhunshëm siç janë faktorët tërheqës (mungesa e perspektivës), faktorët shtytës (ideologjinë), faktorët ekonomik dhe social dhe kapaciteti i ulët institucional si dhe integriteti. Prandaj, për të parandaluar që këta faktorë të kontribuojnë në radikalizmin e individëve, strategjia identifikoi këto objektiva kryesore strategjike:

identifikimin e hershëm të shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të synuara; parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit; ndërhyrje me qëllim të zbutjes së rrezikut të radikalizmit të dhunshëm; de-radikalizmi dhe riintegrimi i personave të radikalizuar. Secili prej këtyre objektivave është ndarë më tej në masa gjithëpërfshirëse dhe programe konkrete.

Shteti laik dhe liria e fesë në kornizën ligjore të Kosovës

Republika e Kosovës është shtet laik dhe është neutral në çështjet e besimeve fetare.

Neni 38 i Kushtetutës së Kosovës parasheh lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. 1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë përfshin të drejtën për të pranuar dhe manifestuar fenë, të drejtën për të shprehur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar anëtarësimin në një bashkësi ose grup fetar. 3. Askush nuk duhet të praktikohet ose të mos lejohet të praktikojë fenë dhe askush nuk duhet të bëjë publike mendimet dhe bindjet e tij / saj. 4. Liria e manifestimit të fesë, besimeve dhe ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj nëse është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë dhe rendin publik ose shëndetin ose të drejtat e personave të tjerë.

Neni 40 i Kushtetutës së Kosovës parashikon lirinë e shprehjes. 1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur veten, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera pa pengesa. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në rastet kur është e domosdoshme parandalimi i inkurajimit ose provokimit të dhunës dhe armiqësisë për shkak të racës, kombësisë, përkatësisë etnike ose të fesë.

Korniza Ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 16 qershor 2008
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Janar 1, 2013
3. Kuvendi i Kosovës - Ligji Nr 05 / L -002 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, mars 2015
4. Kuvendi i Kosovës - Ligji Nr 03 / L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Kuvendi i Kosovës, 30 shtator 2010
5. Kuvendi i Kosovës - Ligji Nr 04 / L-178 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 03 / L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Kuvendi i Kosovës, 11 shkurt 2013
6. Republika e Kosovës Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit (2009-2012), Qeveria e Kosovës, qershor 2009
7. Republika e Kosovës Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit (2012-2017), Qeveria e Kosovës, qershor 2012
8. Qeveria e Kosovës - Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në Terrorizm (2015-2020), Qeveria e Kosovës, në shtator 2015
9. Qeveria e Kosovës - Raporti vjetor i implementimit të Strategjisë Kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë. Raporti i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, tetor 2016

Shtojca D Mënyrat strategjike për t'i mbështetur shkollat në gjetjen e partnerëve

Qendra për Ekselencë RAN²⁸ - Qendër e Komisionuar nga DG HOME (Komisioni Evropian) është një rrjet ombrellë i praktikuesve dhe të tjerëve të përfshirë në luftën kundër radikalizmit që shpie në ekstremizëm të dhunshëm. Në vitin 2016 ata ofruan katër mënyra strategjike për t'i mbështetur shkollat në gjetjen e partnerëve për trajtimin e nevojave që shkollat i kanë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

1. Shkollat që mësojnë nga shkollat

Shkollat mund të ndihmohen drejtpërdrejtë nga njëra-tjetra duke i shkëmbyer përvojat e ndryshme. Ky proces mund të lehtësohet nga qeveritë, duke u anëtarësuar në rrjete të ndryshme apo duke marrë pjesë në ngjarje të ndryshme, madje edhe përmes platformave si ato të projekteve të binjakëzimit (Twinning Project).

2. Intitucionet lokale dhe rrjetet ekzistuese lokale

Shumica e partnerëve që mund ta ndihmojnë shkollën në parandalimin e radikalizmit mund të gjenden në nivel lokal, në mjedisin e drejtpërdrejtë të shkollës ose përreth saj. Autoritetet lokale dhe rrjetet ekzistuese lokale të profesionistëve dhe OJQ-ve shumë shpesh mund të kenë një rrjet më të fortë dhe më të gjerë. Ata mund ta ndihmojnë shkollën në gjetjen e partnerëve dhe të bashkëpunojë me ta.

3. Institutet e trajnimit dhe qendra e ekspertizës

Universitetet, qendrat e ekspertizës dhe institutet e trajnimit mund ta kenë një pasqyrë të shembujve të partneritetit në vende të tjera. Ata mund ta ndihmojnë shkollën me ekspertizë përmes trajnimeve, konsultimeve dhe mënyrave të tjera të shpërndarjes. Qeveritë mund t'i mbështesin këto institucione të cilat vihen më pas në shërbim të shkollave.

28 https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network_en

Fjalorthi²⁹

Anti-semitizmi i referohet diskriminimit, armiqësisë, persekutimit dhe paragjyqimit që si target kanë hebrenjtë.

Kalifi është një sundimtar politik, ushtarak dhe administrativ i bashkësisë myslimane, duke shërbyer si pasardhës i profetit Muhamed. Prejardhja e Muhamedit është burim i mosmarrëveshjes teologjike brenda Islamit, veçanërisht midis sekteve islamike të sunitëve dhe shiitëve. (Termet e lidhur: kalifati, khilafah)

Kalifati (arabisht: khilafah) është termi për një shtet islamik të qeverisur nga një kalif, që shërben si pasues i profetit Muhamed. Kalifati osman (1517-1924) konsiderohet nga shumë muslimanë sunitë që të jetë kalifati i fundit legjitim. (Termet e ngjashme: kalif, khilafah)

Ekstremizmi islam është një ideologji që mbron riorganizimin e shoqërisë rreth parimeve fundamentaliste islamike; që kundërshtojnë tolerancën, diversitetin e mendimit dhe lirinë individuale.

Ekstremizmi i ekstremit të majtë është një ideologji që mbron idealet anti-kapitaliste, anti-imperialiste dhe pro-socialiste. Grupet ekstremiste të krahut të majtë kërkojnë të sjellin ndryshime shoqërore nëpërmjet taktikave revolucionare. Përkrahësit e shohin veten si avokatë kundër shtypjes. Përfshinë organizata të dhunshme nacionaliste si Forcat Revolucionare të Armatosura të Kolumbisë (FARC) dhe grupet separatiste ekstremiste portorikane që ishin aktive në vitet 1970, 1980 dhe 1990.

Ekstremizmi i ekstremit të djathtë është një formë e ideologjisë konservatore që zakonisht mbështet neo-nazizmin, racizmin dhe ksenofobinë.

Luftëtar i huaj është një militant që udhëton nga vendi i tij ose saj për të luftuar së bashku me një organizatë jo-shtetërore. Përdorimi bashkëkohor shpesh i referohet individëve që udhëtojnë për t'u lidhur me një organizatë terroriste jashtë vendit. (Terma të ngjashme: luftëtar i huaj terrorist, hijrah, muhajir)

Xhihadi është një term islamik që përkthehet ndryshe si "luftë", "luftë" ose

29 Permbajtja e Fjalorthit është permbledhur duke u bazuar ne dokumentin e Projektit per Luftimin e Ektremizimit. Per me shume vizito: Counter Extremism Project <https://www.counterextremism.com/about>

"luftë e shenjtë". Grupet ekstremiste islamike zakonisht e përkthejnë termin si "luftë të shenjtë", duke e quajtur fjalën si justifikim dhe duke thirrur për t'u angazhuar në konflikte të dhunshme me jo-islamistët. (Termet përkatëse: muxhahid, muxhahid, xhihadist, xhihadizëm)

Xhihadizmi është besimi në nevojën e përdorimit të xhihadit për të ndjekur synimet islamike. Themeluesit e Vëllazërisë Myslimane dhe Al-Kaidës, si dhe Sayyid Qutb, secili shpalli bindjen se xhihadi kundër jobesimtarëve duhet të jetë një detyrim individual ndaj çdo myslimani. Ky interpretim hodhi poshtë mendimet paraprake që dijetarët islamikë ishin përgjegjës për thirrjen e xhihadit. (Termet e lidhur: muxhahid, muxhahid, xhihad, xhihadist)

Muxhahidët (anglisht: xhihadistët) janë term që përdoret për t'iu referuar individëve që kanë marrë xhihad të dhunshëm. Termi u përhap në vitet 1980 duke iu referuar luftëtarëve afganë në Luftën Sovjetike-Afgane. Anëtarët e grupeve të dhunshme ekstremiste islamike kanë marrë këtë mandat për t'iu referuar luftëtarëve të tyre guerrilas. (Termet përkatëse: muxhahid, muxhahidë, xhihad, xhihadist, xhihadizëm)

Neo-Fashizmi është një lëvizje politike që kërkon të krijojë një shoqëri racore ose etnike homogjene nën një udhëheqës të pajisur me pushtet autoritar. (Termi në fjalë: neo-nazizëm)

Neo-nacizmi është një lëvizje që mbështet ideologjinë raciste, fashiste dhe ksenofobike të Gjermanisë naziste. Neo-nazistët zakonisht i shohin hebrenjtë si armikun e tyre kryesor. (Termi në fjalë: neofashizëm)

Racizmi është besimi se raca të veçanta janë superiore ndaj të tjerëve dhe se inteligjenca dhe aftësia morale e një personi mund të përcaktohet nga raca e tij. (Termi përkatës: racist)

Sheriati është një term arab për ligjin islam që rrjedh nga Kur'ani dhe hadithi.

Vehabizmi - Vahhabizmi është një sekt i Islamit me origjinë nga Arabia Saudite në fillim të shekullit të 18-të. Dikton një interpretim të rreptë të Kur'anit dhe prezanton konceptin e tekfirit, ku disa myslimanë mund të klasifikoheshin si kuffarë (jo besimtarë) dhe kështu t'i nënshtrohen ekzekutimit. (Terma të ngjashme: kafir, salafizëm, takfir)

ISIS - Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë, i njohur edhe si Shtetit Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL) është një grup sunit islamik terrorist dhe brutal, aktiv në Irak dhe Siri. Ky grup bën pjesë në një grup me ideologji botërore xhihadiste, dhe qëndron pas një interpretimi ekstrem të Islamit i cili është anti-perëndimor dhe nxit dhunën sektare. ISIS synon që ta krijojë një shtet islamik të qeverisur nga ligji i Sheriatit si dhe t'i imponojë rregullat e veta mbi njerëzit duke e përdorur dhunën dhe zhatjen.

Jabhat Al Nusra është pjesë e Al Qa'ida (AQ) - Frymëzuar dhe udhëhequr nga Usama Bin Laden, qëllimet e saj janë dëbimi i forcave perëndimore nga Arabia Saudite, shkatërrimi i Izraelit dhe fundi i ndikimit perëndimor në botën myslimane.

Ahrar al-Sham, i njohur edhe si Harakat Ahrar al-Sham al-Islamiyya, ose Lëvizja Islame e të Lirëve të Levantit, është një grup militant salafist sunit që vepron në Siri e që synon ta zëvendësojë regjimin e Asadit me një qeveri islame.